



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 03.07.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 11 dhe 18 qershor 2018.

2. Njoftim për përfundimin e afatit të aplikimit për kandidatët për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe kandidaturat e paraqitura.

3. Vazhdimi i shqyrtimit nen për nen dhe miratimi në tërësi i projektligjit “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”.

(Komision përgjegjës)

4. Shqyrtimi nen për nen dhe miratimi në tërësi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

(Komision përgjegjës)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka, Elena Xhina, Xhemal Qefalia, Arben Pëllumbi dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi (Tyli), Astrit Veliaj.

Të ftuar:

Toni Gogu - Zëvendësministër i Drejtësisë

Adrian Shega - Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit
në Ministrinë e Drejtësisë

Maks Haxhia - Kryetar i DHKA-së

Rezarta Abdiu - Drejtore e Programit të Trajnimit Vazhdues në Dhomën Kombëtare të
Avokatisë

Jon Smibert - Këshilltar ligjor rezident i OPDAT-it

Armanda Sellaj - Këshilltare ligjore vendase e OPDAT-it

Agnes Bernhard - Shefe e misionit të EURALIUS-it

Klodiana Vogli- Këshilltare ligjore vendase e EURALIUS-it

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme, meqenëse plotësohet kuorumi.

Ju kërkojmë ndjesë për fillim e mbledhjes me vonesë, por kjo ndodhi për shkak se një pjesë e deputetëve të Komisionit të Ligjeve janë edhe anëtarë të Komisionit të Reformës Zgjedhore, e cila ka nisur mbledhjen sot, që në orën 9:30!

Sot në rendin e ditës kemi: miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 11 dhe 18 qershor 2018.

A ka vërejtje për procesverbalet? Nuk ka.

Miratojen procesverbalet e datave 11 dhe 18 qershor 2018.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi: njoftimin për përfundimin e afatit të aplikimit për kandidatët për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe kandidaturat e paraqitura.

Pika e tretë e rendit të ditës është vazhdimi i shqyrtimit nen për nen dhe miratimi në tërësi i projektligjit “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”. Edhe për këtë projektligj ne jemi komision përgjegjës.

Pikë e katërt e rendit të ditës është shqyrtimi nen për nen dhe miratimi në tërësi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Edhe për këtë projektligj, komisioni ynë është komision përgjegjës.

Vazhdojmë me rendin e ditës, njoftimin për përfundimin e afatit të aplikimit për kandidatët për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe kandidaturat e paraqitura.

I bëj me dije komisionit se, bazuar në vendimin nr. 74, datë 31.05.2018 të Kuvendit të Shqipërisë, në përfundim të afatit të parashikuar në shpalljen për hapjen e procedurës së aplikimit për 5 vende vakante për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr. 115 të vitit 2016, kanë shprehur interes dhe kanë paraqitur dokumentacionin shoqërues kandidatët e mëposhtëm: Saimir Vishaj dhe Artan Spahiu. Për shkak të numrit të pamjaftueshëm të kandidaturave, pasi numri i vendeve vakante është 5, Komisioni për Çështjet Ligjore e ka të pamundur të vazhdojë me procedurat e

mëtejshme të parashikuara në vendimin nr. 74 të Kuvendit të Shqipërisë. Për këtë arsye, i propozoj komisionit që të vendosë edhe një herë për shpalljen e procedurës së aplikimit për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” sipas afateve të parashikuara në vendimin nr. 74 të Kuvendit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka kandidatura të mjaftueshme, kanë ardhur vetëm dy aplikime dhe duke qenë se shpallja e parë ka qenë 15 ditë pune, unë i propozoj komisionit që ta shtyjë edhe një herë në të njëjtin afat, që t’u japim mundësinë kandidatëve të tjerë për të aplikuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne rregull, por duhet një vendimmarrje e komisionit.

A jeni dakord që ta shtyjë shpalljen e njoftimit?

Kush është dakord? Kundër? 1. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet shtyrja për shpalljen edhe njëherë e procedurës së aplikimit për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr. 115/2016, sipas afateve të parashikuara në vendimin nr. 74 të Kuvendit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 03.07.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Vazhdimi i shqyrtimit nen për nen dhe miratimi në tërësi i projektligjit “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”.

(Komision përgjegjës)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka, Elena Xhina, Xhemal Qefalia, Arben Pëllumbi dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi (Tyli), Astrit Veliaj.

Të ftuar:

Toni Gogu - Zëvendësministër i Drejtësisë

Adrian Shega - Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Maks Haxhia - Kryetar i DHKA-së

Rezarta Abdiu - Drejtore e Programit të Trajnimit Vazhdues në Dhomën Kombëtare të Avokatisë

Jon Smibert - Këshilltar ligjor rezident i OPDAT-it

Armanda Sellaj - Këshilltare ligjore vendase e OPDAT-it

Agnes Bernhard - Shefe e misionit të EURALIUS-it

Klodiana Vogli- Këshilltare ligjore vendase e EURALIUS-i

Ulsi Manja - Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës, vazhdimin e shqyrtimit nën për nën dhe miratimi në tërësi i projektligjit “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”. Për shqyrtimin e këtij projektligji jemi komision përgjegjës, relator i këtij projektligji është zoti Adnor Shameti.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Drejtësisë zoti Toni Gogu, zëvendësministër, zoti Adrian Shega, drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit, dhe nga Dhoma e Kombëtare Avokatisë zoti Maks Haxhia, kryetar i Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe zonja Rrezarta Avdiu, drejtoreshë e Programit të Trajnimit Vazhdues.

Pjesëmarrësit kanë zënë vendin në tryezën e Komisionit të Ligjeve dhe ne mund të vazhdojmë, pa humbur kohë, me shqyrtimin e neneve të mbetura të projektligjit “Për profesionin e avokatit” dhe miratimin në tërësi të këtij projektligji. Në qoftë se nuk gabojmë, nga mbledhja e fundit kemi lënë të hapur nenet 8, 9, 11 dhe nenin 55, “Dispozitën kalimtare”, të këtij projektligji.

I lutem relatorit të ndjekë nenet e mbetura për t’i votuar.

Neni 8 “Detyrat e avokatit”. Në këtë nën kemi futur nenin 8/1 “Konflikti i interesit” dhe pastaj nën 8/2 “Konfidencialiteti”.

Fjala për relatorin.

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Në nenin 8 të ligjit “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” janë përcaktuar detyrat e avokatit. Varianti i paraqitur përpara komisionit sot është variant i dakordësuar si me Dhomën, ashtu edhe me Ministrinë e Drejtësisë. Në këto kushte ju ftoj ta kalojmë në këtë format që është paraqitur.

Ulsi Manja – Ministria e Drejtësisë.

Adrian Shega – Jemi dakord.

Ulsi Manja – A është dakord Dhoma?

Maks Haxhia – Dakord.

Ulsi Manja – Misioni i EURALIUS-it, a ka ndonjë gjë për të shtuar në lidhje me nenin 8?

Agnes Bernhard – Dakord.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 8? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 8.

Kalojmë te neni 9 “Të drejtat e avokatit”.

Urdhëroni, zoti Shameti!

Adnor Shameti – Neni 9 ka të bëjë me të drejtat e avokatit. Varianti i paraqitur para komisionit është i dakordësuar si me Dhomën, ashtu dhe me Ministrinë e Drejtësisë, prandaj ju ftoj ta kalojmë në formatin e paraqitur.

Ulsi Manja - Pra, është riformuluar germa “d” e nenit 9?

Ulsi Manja – Ministria e Drejtësisë jeni dakord?

Adrian Shega – Jemi dakord.

Ulsi Manja – A është dakord Dhoma?

Maks Haxhia – Dakord.

Ulsi Manja – Misioni i EURALIUS-it dakord.

Kush është dakord me nenin 9? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 9.

Neni 11 “Fitimi i titullit të avokatit”.

Urdhëroni, zoti Shameti!

Adnor Shameti – Neni 11 ka të bëjë me fitimin e titullit të avokatit. Si çështje e hapur në dy variante ka qenë ajo e dhënies së provimit të shtetit, përfundimisht, pas diskutimeve që kemi pasur me Ministrinë e Drejtësisë dhe me Dhomën, sugjeroj që të ë varianti pa kushtin e dhënies së provimit të shtetit për fitimin e titullit të avokatit.

Ulsi Manja – Ministria e Drejtësisë.

Adrian Shega – Zoti kryetar, ne kemi një qëndrim publik, të cilin e kemi mbajtur në komisionin që ju keni thirrur për provimin e shtetit, kështu që i qëndrojmë asaj gjëje, për aq kohë sa është pjesë e ligjeve integrale të reformës.

Ulsi Manja – A është dakord Dhoma?

Maks Haxhia – Ne jemi dakord, përveçse kemi për të diskutuar gjerat “dh” dhe “i”.

Ulsi Manja – Pa shkuar te gjerat “dh” dhe “i”.

Zonja Bushka ka një shpjegim lidhur me këtë nen.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti kryetar!

Në lidhje me detyrimin për dhënien e provimit të shtetit për juristët, si kusht për fitimin e titullit të avokatit, në konsultim me relatorin dhe me anëtarë të komisionit, në fakt, ne kemi sugjeruar që të hiqet ky parashikim në këtë nen, sepse do të jetë pjesë e rregullimit të posaçëm në ligjin “Për provimin e shtetit për juristin”. Duke qenë se ai i ligj do të ketë një spektër të gjerë dhe do të komunikojë atje rregulla jo vetëm për avokatët, por edhe për juristët e tjerë, duke qenë se edhe ai si ligj është në proces rishikimi në draftin paraprak që ka ardhur ne sugjerojmë, që në draftligjin për avokatinë ta heqim si kusht, sepse do të jetë pjesë e rregullimit në ligjin tjetër.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

A ka ndërhyrje të tjera për nenin 11?

Urdhëroni, zoti Haxhia!

Maks Haxhia – Ne propozojmë që germa “dh” të riformulohet në këtë mënyrë: “Të mos jetë dënuar për një vepër penale, me vendim të formës së prerë, e cila bie ndesh me integritetin dhe moralin e ushtrimit të profesionit të avokatit. Modaliteti dhe rrethi i veprave rregulluar me statut”. Kjo është më e saktë.

Ulsi Manja - Zoti Shameti, lidhur me riformulimin që propozohet.

Adnor Shameti – Nuk shikoj ndonjë problem në lidhje me këtë sugjerim, sepse është më e gjerë. Vetë Dhoma Kombëtare e Avokatisë ka autoritetin dhe atributin, që të identifikojë rast pas rasti edhe grupin e veprave që realisht ndikojnë në performancën dhe dinjitetin e çdo personi që do të ushtrojë avokatinë.

Ulsi Manja – Misioni i EURALIUS-it, është dakord?

Ju lutem, përkthejeni për efekt traskiptimi në procesverbal!

Agnes Bernhard – *(përkthen përkthyesi)* Mendojmë që të lihet ashtu siç është, sepse në formën që është, mendoj se është në përputhje me formulimin dhe me hartimin e drafteve të tjera, që kanë pasur lidhje me statusin dhe që janë hartuar nga të njëjtat institucione.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Bushka!

Klotilda Bushka – Vë re se varianti që na është paraqitur, me propozimin që bën kryetari i Dhomës së Avokatisë, në thelb parashikojnë të njëjtën gjë. Nuk e di nëse nga çështja e përkthimit nga anglishtja në shqip ka ndonjë ndryshim, që mendojnë ndryshe, por nëse do t'i lexojmë pikat 1, 2 dhe 3 të germës “z” në thelb janë e njëjta gjë asaj që propozon zoti Haxhia, thjesht janë më të detajuar. Për shembull, në qoftë se flasim për vepër penale, në paragrafin e parë thuhet: “Vepër kryer me dashje” në paragrafin e “Vepër e kryer me pakujdesi” dhe në paragrafin e tretë flitet për integritetin e profesionit të avokatit, pra vepra që kanë cenuar këtë çështje. Propozimi që bën zoti Haxhia, nëse nuk e kam gabim, është përmbledhje në një fjali të vetme të të tria elementeve, është çështje e teknikës legislative. Në fakt, sipas traditës sonë juridike, ne nuk i kemi shumë narrative shpjegimet e ligjeve, por në të dyja versionet qëndron logjika. Kështu që mbetet vetëm për të dakordësuar se cila nga çështjet që parashikohet në versionin e paraqitur me tri nënpika, nuk mbulohet nga propozimi i zotit Haxhia, në mënyrë që gjithçka që ka pasur si qëllim ky paragraf të përfshihet në atë që do të miratojmë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

Urdhëroni, zoti Shameti!

Adnor Shameti – Zoti kryetar, kam një sqarim, në seancat paraprake që kemi pasur bashkë me përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë dhe të Dhomës, ne e kemi dakordësuar këtë variant të paraqitur në draftin që, iu është paraqitur anëtarëve të komisionit dhe në thelb i qëndrojmë këtij drafti. Ajo që kryetari i Dhomës, unë dhe kolegja Bushka kemi paraqitur është: a ka nevojë, për teknikë legislative, ta kemi kaq të detajuar te ligji, apo t’ia kalojmë Dhomës që t’i bëjë këto parashikime në statutin.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shameti!

Urdhëroni, zoti Hyseni!

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Pa u zgjatur, mendoj se disa formulime të zgjeruara ndonjëherë nuk ndihmojnë në përmirësimin e situatës. Për shembull, te pika 2, germa “i” thuhet: “Për një vepër të kryer në pakujdesi, e cila nuk është rehabilituar, por cenon figurën dhe integritetin”. Unë mendoj se vepra që cenojnë figurën, mund të jetë tipike korrupsioni, por a ka korrupsion në pakujdesi? Nuk ka. Prandaj disa formulime janë jo të pjekura këtu dhe bëjmë mirë të qëndrojmë te formulimi i përgjithshëm i Dhomës. Më pas Dhoma të gjejë kategorinë e saktë të veprave, që t’i rregullojmë me statut, sepse po bëjmë disa gafa fëmijërore në formulim dhe nesër do të na qeshin studentët kur të lexojnë. Unë e kam këtë parim. Këto që shkruajmë ne sot, do të lexohen për shumë vite pas. Kështu që sa të hedhim firmën dhe të lëmë gjurmë në këtë aspekt, më mirë të jemi të kujdesshëm. Pra, fryma e kërkesës së EURALIUS-it mendoj se duhet të gjejë zgjidhje të detajuar në statut. Kurse si frymë, gjen zgjidhje në propozimin e përgjithshëm të Dhomës.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Urdhëroni, zoti Haxhia!

Maks Haxhia – Po e lexoj edhe një herë formulimin, pra të tria pikat përmbledhen në një pikë, ku thuhet: “Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për një vepër penale, e cila bie ndesh me integritetin dhe moralin e ushtrimit të profesionit të avokatit. Modaliteti dhe rrethi i veprave rregullohen me statut”. Me këtë dua të them atë që thanë edhe kolegët juristë dhe anëtarë të nderuar të komisionit, që në kuptimin juridik të teorisë penale përfshihen të gjitha kategoritë e veprave në nocionin penal. Pastaj specifikimet e këtyre veprave do të akordohen me integritetin dhe moralin, dhe do të veçohen cilat vepra penale nuk lejojnë personat që të ushtrojnë profesionin e avokatit.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Haxhia!

Urdhëroni, zonja Bernhard!

Agnes Bernhard – *(përkthen përkthyesi)* Sigurisht, do të jetë legjislatori ai që do të vendosë, por unë mendoj se duhet të jeni të kujdesshëm te çështjet që mbulohen. Pra, e vetmja gjë ku dua të vë theksin është fakti se formulimi i propozuar nga Dhoma nuk mbulon rastet kur vepra penale është rehabilituar. Lidhur me këtë është dhe një çështje tjetër, që doja ta vendosja.

Dua t'ju pyes për diçka tjetër: a nuk mendoni se do të ishte më mirë që të kishim këtë formulim, sepse është pikërisht ky, që është në përputhje me standardet, me dokumentet e tjera, që lidhen me avokatët? Vetëm në këtë mënyrë ne do t'i lejojmë Dhomës që të mos fusë persona, të cilët kanë marrë dënime në aspektin disiplinor. Pra, është çështja e integritetit, nuk ka të bëjë me aftësinë apo me performancën e avokatëve, por vetëm për çështje disiplinore.

Ulsi Manja – Urdhëroni, zoti Haxhia!

Maks Haxhia - Lidhur me shqetësimin e përfaqësueses së titullares së EURALIUS-it i jap këtë shpjegim dhe pozicionohem kundër për disa arsye.

Së pari, ne, me formulimin që kemi si Dhomë, përjashtojmë nga e drejta për të ushtruar profesionin e avokatit këtë kategori njerëzish, të cilët, për shkak të veprës, kanë marrë një dënim të formës së prerë nga gjykatat dhe bien ndesh me moralin dhe integritetin e ushtrimit të profesionit të avokatit, si për shembull, personat që janë dënuar për marrëdhënie seksuale me dhunë, korrupsion, pedofili, vrasje ose akte terrorizmi, ndërsa të tjerët kanë kohën e rehabilitimit. Kështu që ne përjashtojmë një kategori në ushtrimin e këtij profesioni, ndërsa të tjerët, të cilët janë dënuar për vepra penale, kanë kohën e rehabilitimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, ata do të përcaktohen me statut. Meqenëse janë shumë vepra penale do të merren me radhë dhe Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare do të përcaktojë edhe rrezen e veprave që nuk lejohet të ushtrojë profesionin.

Lidhur me shqetësimin e dytë që ngritët, unë them se jemi para ushtrimit të një profesioni dhe nuk mundet që kufizimi për të ushtruar profesionin në Republikën e Shqipërisë të pengohet nga një vendim i komisionit disiplinor, siç është mungesa e integritetit. Nëse gjyqtarët ose prokurorët largohen nga pozicioni si gjyqtarë ose prokurorë për shkaqe, të cilat janë në kuadër të veprës penale, ata duhet të çohen para drejtësisë, të gjykohen dhe, nëse deklarohen fajtorë, të merret vendimi i formës së prerë. Nuk mundet që një masë disiplinore të kushtëzohet dhe të hyjë paralelisht në komunitetin tonë, kur ne kemi masat tona disiplinore të marra nga Komiteti i Disiplinës dhe masa disiplinore ka një afat parashkrimi. Kështu që ne, përfaqësuesit e Dhomës, jemi të pozicionuar në këtë vlerësim.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit!

Po, zonja Bernhard.

Agnes Bernhard – *(përkthen përkthyesi)* Sigurisht që skema disiplinore është mjaft e ndryshme nga skema penale. Pra, skema disiplinore presupozon veprime shumë më të zbutura dhe, sigurisht, që nuk përfshin përgjegjësinë penale. Prandaj, mendoj se është Dhoma, e cila duhet të marrë në konsideratë dhe t'i krijojë vetes mundësinë që të përjashtojë ata persona, integriteti i të cilëve ka qenë i cenuar me veprime që kanë kryer në të kaluarën.

Ulsi Manja- Po, zoti Haxhia.

Maks Haxhia- Unë jam dakord me atë që thotë e nderuara, por duhet të dimë se askujt nuk i lejohet të marrë pozicionin e gjykatës dhe të caktojë masën e implikimit moral apo të integritetit të një personi, siç është rasti i ish-gjyqtarëve apo ish-prokurorëve që do të largohen. Masa e kriminalizimit të tyre përcaktohen vetëm nga një organ, që është gjykata.

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Haxhia!

Lidhur me variantin e nenit 11, germa “dh”, siç është formuluar me tri pika, dua të di se ku qëndron ndryshimi mes variantit që propozon zoti Haxhia dhe variantit që kemi në projektligj?

Po, zonja Bernhard.

Agnes Bernhard – *(përkthen përkthyesi)* Dua t’ju sqaroj se OPDAT-i është dakord me versionin e propozuar nga ana jonë.

Ulsi Manja – Ky që është në tekstin e projektligjit?

Agnes Bernhard – *(përkthen përkthyesi)* Është dakord me propozimin e EURALIUS-it. Pra, duhet të bëjmë këtë shtesë si bazë ligjore, në mënyrë që Dhoma të përjashtojë të gjithë ata persona, integriteti i të cilëve është cenuar rëndë.

Ulsi Manja- Zonja Bushka ka një pyetje. Pastaj kalojmë në votim.

Klotilda Bushka – Kam një pyetje për zonjën Bernhard. Dua të di qëllimin e germës “dh”. Nuk e di nëse jemi të gjithë të qartë, por unë e kuptoj që titulli nuk fitohet nëse kandidati është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Këtu dëgjoj argumente, që i përziejnë masat disiplinore administrative, të cilat janë të ndryshme nga masat që vendosen nga organi gjyqësor. Mënyra se si është formuluar kjo pikë, flet katërcipërisht vetëm për ato raste kur kemi një vendim penal të formës së prerë për dënim. Sipas dispozitave penale, nuk kemi të bëjmë me çështje që lidhen me dispozita administrative. Unë mendoj se nuk është e sqaruar se ku duam të dalim me këtë qëllim, sepse nëse do të flasim për vepër penale, formulimi është në rregull, ndoshta mund ta rregullojmë nga pjesa e teknikës legjislative, por në qoftë se qëllimi është tjetër, kam përshtypjen se nuk mund të përfshihet në germën “dh”. Kështu që unë them të marrin 5 minuta kohë që ta shohin, pasi mendoj se ka pak problem në përkthim.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit, zonja Bushka!

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Sapo dola nga Komisioni i Reformës Zgjedhore dhe njëri tha: “Në dy juristë ka tri mendime”, edhe ju këtu jeni 5-6 juristë dhe mund të keni 10 mendime. Unë e mbështes zonjën Bernhard, sepse i përgjigjet pyetjes që unë kam bërë dikur. Të gjithë këta gjyqtarë dhe prokurorë të korruptuar, që dalin nga vetingu, gjithmonë për arsye profesionale, jo për arsye pasurie, sepse ka raste që komisionet e vlerësimit thonë se Bashkim Fino nuk ka ditur të japë vlerësimet apo vendimet e gjykatës dhe për këtë arsye ai përjashtohet, pse duhet të strehohen te Dhoma e Avokatisë? Ky është thelbi i këtij neni. Pse bëni sikur nuk e kuptoni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lëre profesionin e lirë. Ata i heq vetingu si të paaftë dhe këta i fusin prapë. Po të jetë profesion i lirë, le të bëjnë profesion tjetër, sepse atë profesion ai e ka shkelur me të dyja këmbët. Unë them të qëndrojnë siç është këtu dhe ta kuptoni që ky është thelbi i këtij neni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk kam mbaruar. E dua për procesverbal, nuk e dua as për ty dhe as për Adnorin! Dua që nesër, kur të nxjerr të gjithë shkrimet e mia, të shoh se çfarë kam thënë në përgjithësi.

Unë dua që drejtësia dhe vetingu të jenë të saktë, sepse, duke qenë të tillë, ata njerëz që ikin nga vetingu, të mos gjejnë një strehë në Dhomën e Avokatisë. Absolutisht, jo!

Alket Hyseni – T’i pushkatojmë?

Bashkim Fino – Jo t’i pushkatojmë, por të bëjnë një profesion tjetër.

Sa veta janë sot në Shqipëri që nuk e ushtrojnë të drejtën e profesionit të tyre, inxhinierë, mjekë apo ekonomistë? Pse pushkatim është ky? Jo, nuk janë të aftë ta ushtrojnë atë profesion që kanë. Këta e kanë shkelur me të dyja këmbët dhe nuk kanë të drejtë ta justifikojnë nesër nëpërmjet Dhomës së Avokatisë. Prandaj unë them të ngelet siç është në draft.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Po, zoti Haxhia.

Maks Haxhia – Zoti Kryetar, shqetësimi i zotit Fino, nga pikëpamja morale, mund të jetë i drejtë, por nga pikëpamja ligjore bie ndesh me parimet e ushtrimit dhe funksionimit të profesionit të avokatisë.

Unë vij nga takimi vjetor që bëhet nga Këshilli i Dhomave të Avokatisë të Vendeve të Bashkimit European dhe janë diskutuar pikërisht këto pika. Ky është një profesion i lirë, i rregulluar me ligj të veçantë për funksionimin dhe ushtrimin e këtij profesioni dhe, duke qenë i tillë, është i lirë që të ushtrojë vullnetin, të hyjë në këtë profesion, por për t’u futur ka disa

rregulla dhe disa barriera funksionimi. Një nga barrierat e funksionimit është nëse është ose jo i dënuar dhe nëse është i tillë nuk e vlerësoj unë, që u largua nga komisionet e vetingut për imoralitet, për integritet apo për paaftësi profesionale, por është në një treg të lirë. Nëse është i paaftë atje, do të jetë i paaftë edhe këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ju them parimet e ushtrimit të profesionit në të gjithë botën, nuk e kemi shpikur ne, sepse ne jemi të rinj fare, vetëm 28 vjet kemi avokati në Shqipëri. Prandaj, avokatia dhe institucionet e saj nuk mund të marrin rolin e gjykatësit. Nëse vetingu përjashton dikë, ta çojë në gjykatë, të bëjë kallëzim dhe të marrë vendim. Atë nuk e pranoj unë!

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Haxhia!

Ka një propozim të zotit Haxhia për riformulim të germës (dh) dhe varianti i projektligjit i parashikuar në nenin 11 germa “dh”. Sipas Rregullores, hedhim në votim propozimin më të largët, atë të zotit Haxhia, për riformulimin e

Alket Hyseni – A mund të flas për procedurë?

Ulsi Manja – Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Propozimi më i largët është ky, sepse ndryshon më shumë nga drafti sesa ai i zotit Haxhia.

Ulsi Manja – Unë jam i detyruar t’i referohem draftit që kam.

Alket Hyseni – Ky nuk është drafti zyrtar, është drafti i punuar.

Ulsi Manja – Ky është drafti përfundimtar.

Alket Hyseni- Drafti zyrtar është ky dhe është më larg variantit.

Ulsi Manja – Propozimi më i largët është...

Adnor Shameti – Drafti integral.

Alket Hyseni – Nuk është ai, por i dorëzuar në Kuvend. Referencë merret drafti i dorëzuar në Kuvend me firmë.

Ulsi Manja – Propozimi më i largët është propozimi që abstragon nga varianti që la teksti integral i projektligjit, i cili do të votohet në Kuvend dhe si rregull hidhet në votim propozimi më i largët, që është i zotit Haxhia.

Kush është pro me propozimin e zotit Haxhia për riformulimin e germës “dh” të nenit 11? Kundër? Abstenim?

Nuk miratohet propozimi i zotit Haxhia.

Hedhim në votim nenin 11, sipas tekstit integral që propozon relatori. Kush është pro? Kundër? Abstenim? 1 votë kundër, zoti Qefalia.

Miratohet.

Kalojmë te neni 55, që është dispozita kalimtare.

Zoti Shameti, ju lutem!

Adnor Shameti – Në nenin 55 të projektligjit janë parashikuar dispozitat kalimtare. Varianti integral i paraqitur para komisionit është i dakordësuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, sepse ky është një projektligj shumë i rëndësishëm, që prek një komunitet të madh avokatësh, janë 10 mijë avokatë. Të jeni të bindur se sot janë të gjithë sy e veshë në këtë sallë. Ky është një profesion i lirë, ku janë të punësuar rreth 10.000 avokatë.

Adnor Shameti – Varianti integral i paraqitur përpara anëtarëve të komisionit është i dakordësuar me Dhomën dhe Ministrinë e Drejtësisë. Ju ftoj ta votojmë në këtë format.

Ulsi Manja – A janë dakord përfaqësuesit e Dhomës, të Ministrisë dhe të EURALIUS-it me nenin 55, që është dispozitë kalimtare?

Adrian Shega - Dakord.

Ulsi Manja- Atëherë, hedhim në votim nenin 55. Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet nenin 55.

Hedhim në votim në tërësi projektligjin “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zonja Bernhard.

Agnes Bernhard – *(përkthen përkthyesi)* Në lidhje me nenin 14 të ligjit, i cili merret me mënyrat e shpërblimit të avokatit, germa “c”, paragrafi 1, është i ndryshëm nga dispozitat që janë vendosur për sa i përket ndihmës juridike.

Neve na thanë që është mbyllur si nen, por kërkojmë nëse është e mundur që të rihapet përpara votimit në tërësi.

Ulsi Manja – Nuk mund ta hapim, pasi është miratuar edhe procesverbali i mbledhjes së komisionit, ku është miratuar nenin 14. Kështu që ngelet për në seancë plenare, vetëm nëse ka amendament konkret, por duhet të silllet sipas Rregullores së Kuvendit, 24 orë përpara dhe duhet të jetë nismë e mbështetur nga deputetët.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Në qoftë se Dhoma dhe OPDAT-i bien dakord për rregullimin e këtij neni, pse duhet të bëjmë amendament në seancë plenare?

Ulsi Manja- Në qoftë se Dhoma, EURALIUS-i dhe Ministria e Drejtësisë bien dakord për një amendament për nenin 14, le ta dakordësojnë, ne e mbështesim në seancë, sepse ne jemi në fazën e votimit në tërësi të ligjit.

Ardian Shega– Ne jemi dakord.

Ulsi Manja –Nëse jeni dakord për riformulimin e nenit 14 dhe të ketë një amendament shtesë, ne e mbështesim për në seancën që do të miratojmë ligjin.

Hapim votimin në tërësi të projektligjit “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”. Kush është pro? Kundër? Abstenim? 2 kundër, asnjë abstenim.

Miratohet në tërësi projektligji “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”.

Këshilltarët të kenë parasysh rinumërimin e ri që kanë marrë nenet pas disa nenesh shtesë që ne i miratuam në komision dhe i gjithë teksti integral i projektligjit të jetë i numërtuar sipas referencave përkatëse dhe neneve të reja që ne kemi miratuar.

Fjala është për ju, zoti Naço, për shpjegimin e votës kundër.

Nasip Naço – Faleminderit, zoti kryetar!

Votova kundër në tërësi, pasi nuk dija kujt t’ia jepja meritat, zoti kryetar, në lidhje me projektligjin që ju miratuat!

Kemi një draft fillestar, që po e quaj draft zyrtar, të përgatitur nga ekspertët e nivelit të lartë të EURALIUS-it, nga ekspertët më të mirë, si dhe kemi një ndryshim, gati 100%, të këtij projekti fillestar, që është bërë nga relatori dhe nga ekspertë anonimë, përveç ekspertëve ose përfaqësuesve të Ministrisë, të EURALIUS-it apo të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, që kanë ardhur këtu në seancë. Pra, kemi një ligj të ndryshuar 100%, nisur nga megalomania për të bërë 40 ligje, për të bërë një reformë të madhe, dhe e keni parë se në të gjitha projektligjet keni dështuar.

Mjaftoi ky fakt dhe ndryshimi i këtij projektligji 100% nga propozimi fillestar apo ndryshimet e tjera të ligjeve që keni kaluar, për të më dhënë të drejtën të votoja kundër, sepse nuk ka seriozitet. Pra, mjafton të shikosh diskutimet këtu, shto ujë e shto miell, e keni ndryshuar njëqind herë, nuk keni diskutuar me grupet e interesit, pasi ky është një draft tërësisht i ri. Ndaj, nuk e di kujt t’ia jap meritat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është kryetari i Dhomës që përfaqëson të gjithë avokatët.

Ulsi Manja – Atëherë, ta shkarkojmë kryetarin e Dhomës.

(Ilartitet në sallë)

Nasip Naço – Jo, mor, nuk kemi të drejtë ne.

Ti ke të drejtën që çfarëdolloj drafti të sjellin, ta kalosh se...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, qetësi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nasip Naço – Siç e thashë, nuk e di kujt t’ia jap meritat, zoti kryetar, por të gjithë ata...

Ulsi Manja – Jepja kryetarit të Dhomës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nasip Naço – ...që kanë marrë fletë nderi, dekorata apo edhe janë paguar si ekspertë të nivelit të lartë, duke ndryshuar ligjin 100%, duhet t’i kthejnë dekoratat, fletët e nderit dhe pagesat që kanë marrë si ekspertë të nivelit të lartë.

Për ju, sepse për mua janë ekspertët më të mirë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, zoti Naço!

Në fakt, ky është një diskutim i ezauruar. Askush nuk ia heq të drejtën Komisionit të Ligjeve dhe deputetëve të këtij komisioni ta pasurojnë ligjin me sugjerimet, komentet e tyre apo me propozimet përkatëse.

Gjithsesi, këtu mbarojmë me pikën e tretë të rendit të ditës.

Nasip Naço – Zoti Manja, nuk e di si ndihen ata ekspertë që janë edhe këtu, që kanë sjellë një draft tjetër, ia keni ndryshuar dhe mbajnë të njëjtin qëndrim me ju.

Bashkim Fino – Ne kemi të drejtë ta ndryshojmë, more, çfarë lidhjeje ka?!

Nasip Naço – Mbajnë të njëjtin qëndrim me ju. Ka qenë 100% i përgatitur në variantin e parë...

Ulsi Manja – Prandaj jemi deputetë ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nasip Naço – ...dhe po 100% në variantin e dytë.

Ulsi Manja – Jemi deputetë të Komisionit të Ligjeve, zoti Naço!

(Deputetët flasin njëkohësisht)

Nasip Naço – Këtë nuk e kuptoj dot.

Ulsi Manja – Dakord, dakord.

Nasip Naço – Ju mund ta kuptoni, zoti kryetar, por të njëjtin gabim do të ketë në Kodin e Procedurës Penale, neni 491, për të cilin u bë goxha debat, kështu e ndryshuat, këtu gabuat. Nuk them se e keni bërë me dashje, por gabuat, sepse është e njëjta metodë që përdorni.

Faleminderit, zoti kryetar!

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, zoti Naço!

Kjo është një praktikë parlamentare e konsoliduar tashmë. Kështu që nuk besoj se duhet të ndalemi të bëjmë debat.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 03.07.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nen për nen dhe miratimi në tërësi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. (komision përgjegjës)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka, Elena Xhina, Xhemal Qefalia, Arben Pëllumbi dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi (Tyli), Astrit Veliaj.

Të ftuar:

Toni Gogu – Zëvendësministër i Drejtësisë

Adrian Shega – Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Sokol Sadushi – kryetar i Shkollës së Magjistraturës

Jon Smibert – Këshilltar ligjor rezident i Departamentit të Drejtësisë pranë Ambasadës Amerikane (OPDAT)

Armanda Sellaj – Këshilltare ligjore vendase e i Departamentit të Drejtësisë pranë Ambasadës Amerikane (OPDAT)

Agnes Bernhard – Shefe e Misionit Ndërkombëtar EURALIUS

Klodiana Vogli – Këshilltare ligjore vendase e Misionit Ndërkombëtar EURALIUS

Ulsi Manja - Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës, që është shqyrtimi nën për nën dhe miratimi në tërësi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relator është kolegu Shameti.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Drejtësisë, zoti Toni Gogu, zëvendësministër; zoti Adrian Shega, drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit. Nga Departamenti i Drejtësisë pranë Ambasadës Amerikane, OPDAT kemi sot këtu zotin John Smibert, këshilltar ligjor (rezident) dhe zonja Armanda Sellaj, që është këshilltare ligjore vendase.

Nga misioni ndërkombëtar EURALIUS kemi zonjën Agnes Bernhard, shefe e misionit, dhe zonjën Klodiana Vogli, që është këshilltare ligjore vendase.

Ju lutem, zini vendet, në mënyrë që të fillojmë me shqyrtimin nën për nën dhe miratimin në tërësi të projektligjit!

Zoti Shameti, ju lutem, jemi në fazën e miratimit nën për nën të këtij projektligji.

Do të marrim në konsideratë edhe një propozim të fundit, që vjen nga Shkolla, por që është mbështetur edhe nga relatori, lidhur me ndryshimin që kërkohet t’i bëhet pikës 3 të nenit 170.

Siç e dini, projektligji është nismë deputetësh, e zonjës Klotilda Bushka dhe Ulsi Manja, ndërsa relator është kolegu Adnor Shameti.

Fjala për ju, zoti Shameti.

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Në vijim të diskutimeve që kemi bërë në seancën e fundit, ku kemi diskutuar këtë projektligj...

(Deputeti Naço flet pa mikrofon.)

Dua të sjell në vëmendjen e komisionit dhe kërkoj që në nenin 2 të këtij projektligji të shtohet një pikë 3. Pra, në nenin 170 shtohet pika 3, me përmbajtjen si vijon: “Deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe me qëllim plotësimin e nevojave për funksionimin e sistemit të drejtësisë, ngarkohet Shkolla e Magjistraturës të organizojë, jo më vonë se muaji tetor, konkursin për pranimin e 50 kandidatëve për magjistratë për çdo vit akademik. Ndarja e profilit si gjyqtar dhe prokuror për kandidatët fitues për çdo vit akademik do të jetë përkatësisht tre të pestat gjyqtarë dhe dy të pestat prokurorë, që përcaktohet nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, sipas renditjes përfundimtare”.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shameti!

Cili është mendimi i përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë?

Toni Gogu – Shprehem dakord.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Shkolla e Magjistraturës?

Sokol Sadushi – Dakord.

(Diskutime në sallë)

Preferenca merret në konsideratë, pa diskutim, dhe është preferenca ajo që ndan renditjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ata hyjnë të gjithë njëloj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, pesë minuta pushim, sa të vijë kolegu Qefalia!

Mediet të na lënë pak vetëm.

(Pas pushimit)

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, qetësi!

Rifillojmë mbledhjen e komisionit pa shumë zhurmë.

Vazhdojmë me shqyrtimin nen për nen të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96, datë 06.10.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (nismë deputetësh).

Vazhdojmë me nenin 1.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I lutem relatorit të ndjekë kronologjinë e neneve.

Neni 1. Biem dakord?

Adnor Shameti – Shprehem dakord, pasi nuk ka asnjë ndryshim nga varianti i paraqitur.

Ulsi Manja – Ministria bie dakord me nenin 1?

Toni Gogu – Shprehem dakord.

Ulsi Manja – Shkolla e Magjistraturës?

Sokol Sadushi – Shprehem dakord.

Ulsi Manja – Misioni EURALIUS?

Agnes Bernhard – Dakord.

Ulsi Manja – OPDAT-i?

Jon Smibert – Dakord.

Ulsi Manja – Atëherë, meqenëse ka dakordësi për nenin 1, e hedhim në votim, sipas variantit të propozuar. Kundër? Dy vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Neni 2.

(Deputeti Naço ndërhyr pa mikrofon.)

Po, zoti Naço, për shpjegim vote.

Nasip Naço – Faleminderit, zoti kryetar!

Votova kundër për nenin 1, sepse, sikurse e kam deklaruar edhe në parim votën time, nuk shoh ndonjë risi për shkak të reformës në drejtësi. E kam thënë edhe në seancën e kaluar, të gjithë ata që morën dekoratat dhe na bënë një reformë shembullore, sot janë të detyruar t'i kthejnë bashkë me propozimin e këtij neni dhe të këtij projektligji.

Neni 1 nuk kërkon as më shumë, as më pak, por të shtojë pambarimisht afatin e Prokurores së Përgjithshme të përkohshme në detyrë pa asnjë lloj limiti dhe t'i bëjë ajo emërimet e magjistratëve që kanë mbaruar për vitin 2017-2018.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk po i futem më shumë, që të flas për Prokuroren e Përgjithshme, sepse ju e keni zgjedhur me dëshirë, e keni zgjedhur me pasion, sigurisht doni t'i shtoni edhe mandatin me 69 vota, aq sa ia keni shtuar.

Votova kundër nenit 1, sepse keni një kthesë 180 gradë, ju të gjithë, për Këshillin e Lartë të Drejtësisë, pasi kërkon që ky Këshill i Lartë Drejtësie, i anatemuar prej jush, prej nesh, në veçanti edhe nga unë, si ish-ministër i Drejtësisë, lidhur problematikën që kam pasur me Këshillin e Lartë të Drejtësisë, dhe besoj se ky ka qenë edhe qëllimi i një reforme të thellë për ta çmontuar Këshillin e Lartë të Drejtësisë, duke filluar që nga Presidenti i Republikës, kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, kryetari i Gjykatës Kushtetuese, asnjëri nuk është i përfshirë në pjesën e reformës për qëllimin bllokues që mbanin ndaj reformës, për qëllimin bllokues që mbanin ndaj sistemit gjyqësor, nuk mund të kthehem përsëri 180 gradë dhe, për studentët e Magjistraturës që kanë mbaruar, t'u themi një pjese të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë bëjini ju emërimet. Pra, nuk do të pranoj asnjëherë që këta studentë të Magjistraturës të kërkojnë ndere dhe qokën e radhës, që në ditën e tyre të parë të punës nga anëtarët e KLD-së për t'i emëruar në vendet që ata preferojnë dhe jo sipas meritës dhe aftësive, që kanë mbaruar Shkollën e Magjistraturës...

Në këto kushte, nuk kam se si ta votoj nenin 1 dhe prandaj vota jonë, pra imja dhe e Grupit Parlamentar të LSI-së, do të jetë votë kundër për nenin 1.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Naço!

Vazhdojmë me nenin 2.

Relatori?

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Për nenin 2 përsëris propozimin tim që të riformulohet dhe të ketë këtë përmbajtje: “Në nenin 170 shtohet pika 3 me përmbajtjen si vijon: “Deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me qëllim plotësimin e nevojave për funksionimin e sistemit të drejtësisë, ngarkohet Shkolla e Magjistraturës të organizojë, jo më vonë se muaji tetor, konkursin për pranimin e 50 kandidatëve për magjistratë për çdo vit akademik. Ndarja e profilit, si gjyqtar dhe prokuror, për kandidatët fitues për çdo vit akademik do të jetë përkatësisht tre të pestat gjyqtarë dhe dy të pestat prokurorë, që përcaktohet nga këshilli drejtues i Shkollës së Magjistraturës, sipas renditjes përfundimtare”.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shameti!

Si mendon Ministria e Drejtësisë lidhur me nenin 2, me riformulimin e propozuar nga relatori?

Toni Gogu – Shprehemi dakord.

Ulsi Manja – Dakord.

Shkolla e Magjistraturës?

Sokol Sadushi– Dakord.

Ulsi Manja – Misioni EURALIUS?

Agnes Bernhard – Dakord.

Ulsi Manja – Si mendon përfaqësuesi i OPDAT-it?

Jon Smibert – Është në rregull.

Ulsi Manja – Atëherë, hedhim në votim nenin 2, sipas formulimit të propozuar nga relatori. Kush është pro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kundër? Dy vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe neni 2.

Fjalën e ka zoti Naço për shpjegimin e votës së tij kundër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe një nen kemi, Xhemal.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nasip Naço – Faleminderit, zoti kryetar!

Më ngacmoi edhe zoti Fino.

(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)

Herën e kaluar kam deklaruar, lidhur me si do të jetë qëndrimi politik i Grupit Parlamentar të LSI-së, se do ta votoja nenin 170, pra nenin 2, sepse kishte të bënte me studentët e Magjistraturës për t'u mundësuar vitin akademik.

Për sa kohë kam qenë ministër i Drejtësisë, kam mbështetur Shkollën e Magjistraturës, studentët e saj, madje është bërë edhe publike dhe këtu, fatmirësisht, kemi edhe drejtorin e Shkollës së Magjistraturës. Mbi dy vjet Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk i fuste në rendin e ditës për t'i emëruar, ndërkohë që të 13 studentët i kam propozuar në Tiranë dhe, fatkeqësisht, asnjëri nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, prandaj e votova edhe nenin 1 kundër, nuk i emëroi në Tiranë. Ata kishin arsye pse nuk i emëronin. Këta studentë të Shkollës ishin të dobët nga ana fizike, ndërkohë që sollën të tjerë nga rrethet që ishin të dhjamosur. Besoj se e kuptoni arsyen pse ua bënë emërimin atyre gjyqtarëve dhe jo këtyre studentëve.

Në propozimin e sotëm, për të cilin edhe unë kam ndryshuar qëndrim, zoti kryetar, që nuk do ta votoj nenin 2, përveç shtimit të numrit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju keni hequr edhe fjalët “vitin akademik 2018-2019 dhe 2019-2020”.

Ulsi Manja – Ja, ku e ke!

Nasip Naço – Me këtë tregoni se ju nuk do ta krijoni asnjëherë Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe asnjëherë Këshillin e Lartë të Prokurorisë, pra do ta lini në kalendat greke, sepse me këtë formulim që keni bërë, e keni lënë të hapur vitin akademik, duke mos përcaktuar vetëm një vit. Prandaj edhe unë kam ndryshuar qëndrim dhe prandaj votova kundër këtij neni.

Kjo tregon qartë se ju...

(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)

Nuk e kupton, o Fino, që nuk e krijojnë dot KLP-në, KLGJ-në?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e pranojnë dot që dështuan në punën e reformës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Fino, ju lutem!

Nasip Naço – Unë nuk e kam mbaruar ende fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Fino, ta mbarojë fjalën zoti Naço!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Pyeta relatorin unë!

Nasip Naço – Kështu që, duke qenë se ju nuk i keni mundësitë dhe keni dështuar me reformën në drejtësi, e keni anashkaluar, sepse ende nuk po zgjidhni dot cilin do të zgjidhni inspektor të Lartë të Drejtësisë, për shkak të grupeve dhe klaneve që keni brenda Partisë Socialiste...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Votat i keni, Kryetarin e Kuvendit e keni, ndaj mjafton të propozoni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe Këshillin e Monitorimit e keni krijuar sipas variantit tuaj, por nuk e keni propozuar ende...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Madje nuk doni ta propozoni, sepse kur të gjeni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, qetësi!

Nasip Naço – Kur të zgjidhni atë që doni ju, sepse është një nga institucionet më të rëndësishme, nuk e keni arritur ende, po e lini të hapur edhe KLGJ-në, edhe KLP-në për në kalendrat greke. Prandaj e kam votuar kundër.

Ju uroj mbarësi me reformën në drejtësi, të bërë sipas mënyrës dhe variantit tuaj!

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Naço!

Në fakt, ngritjen e KLGJ-së, të KLP-së dhe të SPAK-ut e kemi detyrim kushtetues të gjitha palët politike, sepse ajo çfarë është e shkruar në Kushtetutën e vendit, është detyrim edhe për Kuvendin, edhe për klasën politike, për ta mbështetur, siç e kemi mbështetur me votë në mesnatën e 22 korrikut.

Kështu që, unë nuk besoj se ka ndonjë problem riformulimi i propozuar nga relatori dhe i mbështetur edhe nga Shkolla e Magjistraturës, Ministria e Drejtësisë, misioni EURALIUS dhe OPDAT-i.

Neni 2 u votua, sipas riformulimit përkatës.

Kalojmë te neni 3 “Hyrja në fuqi” e ligjit.

Relatori?

Adnor Shameti – Shprehem dakord me variantin e paraqitur.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 3?

Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 3.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96, datë 06.10.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Dy vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi edhe projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96, datë 06.10.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Fjalën e ka kërkuar kolegja Bushka.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë të Komisionit të Ligjeve...

(Diskutime në sallë)

Ulsi Manja – Ju lutem, pak qetësi!

Klotilda Bushka – Unë ju falënderoj për sensibilitetin që i keni kushtuar reformës në drejtësi!

Në fakt, kam një mesazh për të gjithë ju dhe kolegët e opozitës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në një klimë të tensionuar dhe të polarizuar politikisht, një gjë që duhet të na interesojë të gjithëve, është zbatimi i reformës në drejtësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Reforma në drejtësi nuk është një çështje vetëm e maxhorancës, e opozitës apo një çështje...

(Deputetët e opozitës lënë mbledhjen.)

...e cila i takon një aktori të vetëm politik.

Më vjen keq që po largoheni, sepse e di që, në të vërtetë, mendoni njësoj si unë, por pozicionet politike ju detyrojnë të silleni ndryshe.

Reforma në drejtësi është një çështje që u përket të gjithë shqiptarëve dhe, në këto kushte...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Nuk ka gajle.

Klotilda Bushka – Ajo që doja të jepja si mesazh...

Adnor Shameti – E vonove, Klod...

(Deputeti Shameti flet pa mikrofon.)

Klotilda Bushka – ...është vetëm kjo: në qoftë se kolegët e opozitës në lidhje me këtë nismë legislative të maxhorancës kanë sugjerime për amendime, brenda afateve ligjore, që parashikohen përpara seancës plenare, janë të mirëpritur t'i sjellin me qëllimin e vetëm që në

shtator ne t'i japim mundësi Shkollës së Magjistraturës të kryejë të gjitha procedurat për hapjen e kursit të ri të studentëve të rinj për magjistratë, gjyqtarë dhe prokurorë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

Edhe unë bashkohem me mesazhin e koleges për politikën, që t'i japim mundësinë Shkollës së Magjistraturës të hapë programin e pranimi fillestar në shtator. Gjithsesi, palët reflektojnë qëndrimet politike, por unë shpresoj që në seancën e votimit në Kuvend ky projektligj të marrë mbështetjen e duhur prej tre të pestave të votave, siç e kërkon edhe Rregullorja e Kuvendit.

Me ezaurimin e pikës së katërt të rendit të ditës, e mbyllim për sot mbledhjen e Komisionit të Ligjeve.

Unë dua të falënderoj kolegët për pjesëmarrjen dhe durimin në këtë mbledhje, por edhe personat e ftuar, përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, zotin Gogu; zotin Sadushi nga Shkolla e Magjistraturës; zonjën Bernhard dhe zotin Jon Smibert për pjesëmarrjen në mbledhjen e komisionit!

Vetë prezenca e tyre sot në këtë mbledhje tregon edhe rëndësinë që ka ky projektligj në suksesin e zbatimit të reformës në drejtësi.

Edhe një herë, faleminderit për pjesëmarrjen!

Mbledhja e radhës do t'ju njoftohet nëpërmjet sekretarisë së Komisionit të Ligjeve.

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

